



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data:

Nr:

Ora:

PROJEKTVENDIM

PËR

DHËNIEN E MANDATIT TË KRYETARIT TË BASHKISË RROGOZHINË, QARKU TIRANË Z. EDISON SELMAN MEMOLLA, TË PROPOZUAR NGA SUBJEKTI ZGJEDHOR "PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË", PËR ZGJEDHJET E PËRSËRITURA TË DATËS 23 KORRIK 2023

Sot më datë .7.2023, mora në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Dhënie e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, Qarku Tiranë, z. Edison Selman Memolla, të propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për zgjedhjet e përsëritura të datës 23 Korrik 2023.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, dhe neni 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

VËREJ:

Në mbështetje të Dekretit nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, "Për caktimin e datës së zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore", u zhvilluan zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

Koalicioni "Bashke Fitojmë" dhe kandidati për kryetar bashkie, Bashkia Rrogozhinë, paraqitën pranë Kolegjit Zgjedhor, padi për ndryshimin e vendimit nr. 174, datë 6.6.2023, të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS), pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, "Miratimin e Tabelës së Re Përmbledhëse të Rezultatit për kandidatët për Kryetar Bashkia Rrogozhinë", duke mos përfshirë rezultatin zgjedhor të Qendrës së Votimit Nr. 2224/1, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEPV) Rrogozhinë. Shpalljen fitues për kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, z. Shkëlqim Hamid Hoxha, propozuar nga subjekti zgjedhor "Bashkë Fitojmë".

Data: Nr:

Ora:



Për dhënie e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, Qarku Tiranë, z. Edison Selman Memolla, të propozuar nga subjekti zgjedhor "Partia Socialiste e Shqipërisë", për zgjedhjet e përsëritura të datës 23 Korrik 2023"

Në përfundim të shqyrtimit administrativ, Kolegji Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë vendosi pavlefshmërinë e zgjedhjeve vendore të datës 14 maj 2023 në Zonën e Administrimit Zgjedhor Nr. 43, për Kryetar të Bashkisë Rrogozhinë, duke urdhëruar përsëritjen e këtyre zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në zbatim të vendimit të Kolegjit Zgjedhor me vendimin nr. 678, datë 4.7.2023 “Për caktimin e datës për përsëritjen e zgjedhjeve për Kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë”, caktoi datën 23 Korrik 2023 për zhvillimin e zgjedhjeve të përsëritura për Kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë.

Bazuar në nenin 166, pika 1, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, Kryetar Bashkie zgjidhet kandidati që fiton numrin më të madh të votave të vlefshme të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë vendore përkatëse.

Bazuar në nenin 33, shkronja “g”, Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor nr. 43, me vendimin nr. 118, datë 24.7.2023, ka shpallur fitues z. Edison Selman Memolla, si Kryetar i Bashkisë Rrogozhinë, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, dhe nenin 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S:

1. Dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, Qarku Tiranë, z. Edison Selman Memolla, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: Nr:
Ora:



Për dhënien e mandatit të Kryetarit të Bashkisë Rrogozhinë, Qarku Tiranë, z. Edison Selman Memolla, të propozuar nga subjekti zgjedhor “Partia Socialiste e Shqipërisë”, për zgjedhjet e përsëritura të datës 23 Korrik 2023”